

VENDIM
Nr. 852, datë 4.11.2020

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KUKËS TË NJËSIVE
TAKUESE, PJESE TË PASURISË NR. 25/9, ZONA KADASTRALE 2315, DHE PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 167, DATË 10.3.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË
PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KUKËS, TË QARKUT TË
KUKËSIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit bashkëlidhur vendimit nr. 167, datë 10.3.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përmasat e pronës me emërtimin “Bashkia” zëvendësohen sipas planrilevimit dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Transferimin në pronësi nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës të Bashkia Kukës të njësisë, me sipërfaqe 255 (dyqind e pesëdhjetë e pesë) m², në katin përdhes, pjesë të pasurisë nr. 25/9, zona kadastrale 2315, sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Kalimin në pronësi të Bashkisë Kukës të njësisë me sipërfaqe 558 (pesëqind e pesëdhjetë e tetë) m², në katin e tretë, pjesë të pasurisë nr. 25/9, zona kadastrale 2315, sipas formularit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

4. Pronat e përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të këtij vendimi, i shtohen listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 167, datë 10.3.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

5. Prona e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimit nr. 448, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar.

6. Ngarkohen Bashkia Kukës, Këshilli i Qarkut Kukës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PLAN RILEVIMI

BASHKIA KUKES

Përgatiti:

Ark. Edrion Laçi

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE: 2315

NR.I PASURISË: 25/9

INDEKSI I HARTËS: KU; H-5 SHKALLA: 1:500

ADRESA E PASURISË: BASHKIA KUKES, SHESHI "SKENDERBEJ"

LLOJI I PASURISË: TRUALL

SIPERFAQJA E TRUALLIT : 968 m2

SIPERFAQJA E NDERTESES : 585 m2

B. KUFIZIMET

VERI: 28/7, 25/8

JUG: 25/51, 25/10

LINDJE: 25/10


PERENDIM: 24/37

C. PRONARI

BASHKIA KUKES

D.Data: 16.07.2020


KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE KRGJSH



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni përgjegjës: Bashkia Kukës				Identifikoi: Edrion Laçi, Shefi Sektorit të PKZHT (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)						
Fusha e përdorimit të Pronës: Funksione administrative				Supervizoi: Andrit Shehu, Drejtor i PKZHT (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)						
				Aprovoi: Safet Gjici, Kryetar i Bashkisë Kukës (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)						
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeks i Hartes	Nr. Pasurisë	A Lloji i Pronës	B Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2315 KU-H-5	25/9	Truallë-ndertese	Godina e bashkisë Kukës Lagja nr.5 Bashkia Kukës	968 m2	585 m2	Administratë	Bashkia Kukës	Bashkia Kukës	Godina është 4 Kate Kati përderhe me sip 585 m2 Kati i parë me sip 569 m2 Kati i dytë me sip 558 m2 Kati i tretë me sip 558 m2

GODINA E BASHKISË KUKËS
PLANIMETRIA E KATIT E PËRDHË
SHKALLA 1 : 150
SIP. TOTALE----- 585 M2
SIP.E AMBIENTEVE QË KALOJNË NE PRONËSI TE BASHKISË KUKËS-- 255 M2
SIP.E AMBIENTEVE NE PRONËSI TE BASHKISË KUKËS -----330 M2




AMBIENTET E BASHKISË
SIP. 330 M2

AMBIENTET QË KALOJNË NE PRONËSI
TE BASHKISË KUKËS - SIP= 255 M2


HARTOI : ARK. EDRION LAÇI

GODINA E BASHKISE KUKES
 PLANIMETRIA E KATIT TE PARE
 SHKALLA 1 : 200
 SIP. 569 M2



HARTOI : ARK. EDRION LAÇI


GODINA E BASHKISE KUKES
 PLANIMETRIA E KATIT TE DYTE
 SHKALLA 1 : 150
 SIP. 558 M2



HARTOI : ARK. EDRION LAÇI

PLANIMETRIA E KATIT TE TRETE SH 1 : 150

SIPERFAQE : 558 M2



AMBJENTET QE KALOJNE NE PRONESI
TE BASHKISE KUKES - SIP= 558 M2

HARTOI : ARK. EDRION LAÇI